



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË

AD/GJTHGJA. nr. 01/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – kryetari i gjykatës Nikollë Komani, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga ankuesi O. C. avokat në Pejë, ndaj gjyqtarit D. B., pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datë 25 shtator 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet ankesa disiplinore e parashtruar nga avokati O. C., ndaj gjyqtarit D. B., si e pabazuar.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, O. C. avokat në Pejë, me datën 17 shtator 2024, e ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën me emërtimin “*ankesë*” ndaj gjyqtarit D. B., e që ka të bëjë me seancën dëgjimore të datës 10 shtator 2024.

Pas pranimit të kësaj ankese dhe pas analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me numër AD/GJTHGJA.nr. 01/24 me datën 17 shtator 2024 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të Gjykatës, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Me shkresën AD/GJTHGJA.nr. 01/24 të datës 17 shtator 2024, përmes email-it zyrtar është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për veprimet e ndërmarra lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit.

Ankuesi, O. C. avokat në Pejë, me datë 17 shtator 2024, ka paraqitur ankesë për shkelje disiplinore të bëra nga gjyqtari D. B., në kuptim të dispozitave të nenit 5 par. 1.2 dhe 1.3 në lidhje me nenin 2 par. 1, 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me arsyetimin se gjyqtari në seancën për caktimin e masës së sigurisë me datën 10 shtator 2024 ka dal në seancë i papërgatitur, çka mund të konstatohet se i njëjti nuk i ka përkthyer paraprakisht autorizimin nga klienti i avokatit, i përpiluar në gjuhën serbe, duke mos kuptuar përmbajtjen e të njëjtit edhe pse ka pasur në dispozicion kohë të mjaftueshme për përgatitje. Ka shtuar se gjyqtari jashtë procesverbalit ka kërkuar nga avokati informata për klientin e tij dhe vendbanimin e tij, duke

kërkuar sqarime nga avokati se “çka është problem me qatë lokalën se është interesuar edhe prokuroria”, tutje gjyqtari ka vazhduar duke marrë aktvendim ku e ka detyruar të autorizuarin e propozuesit që për seancën e radhës gjykatës t’i prezantoi autorizimin e noterizuar nga organi noterial në Republikën e Kosovës. Në pikën e dytë të kësaj ankese, ankuesi pretendon se gjyqtari ka bërë shkelje disiplinore në kuptim të dispozitave të nenit 5 par. 1.2 dhe 1.3 në lidhje me nenin 2 par. 1, 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në atë mënyrë që i njëjti në fillim të procedurës nuk ka vepruar në mënyrë profesionale sepse nuk ka vepruar sipas dispozitave të nenit 96 të LPK-së, ku avokatit nuk i ka ofruar mundësi ligjore për tu deklaruar në gjuhën e vet për çka ka pasur obligim ligjor sipas LPK-së. Po ashtu ka shtuar se me datë 10 shtator 2024 në lëndën C.nr.1535/22 ka bërë shkelje disiplinore në kuptim të dispozitave të nenit 5 par. 1.2 dhe 1.3 në lidhje me nenin 2 par. 1, 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në atë mënyrë që edhe pse ka qenë në dijeni se seanca nuk do të mbahet dhe përfaqësuesi i palës paditës vjen nga një qytet tjetër, nuk e ka lajmëruar avokatin duke e pasur një mundësi të tillë në dispozicion. Ka shtuar se ka dyshime në objektivitetin e gjyqtarit në këtë çështje, andaj ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent të zbaton procedurën sipas dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjyqtari D. B., në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e ankuesit ndër të tjera ka theksuar se gjykata e ka caktuar seancën dëgjimore me datë 10 shtator 2024, e cila seancë nuk është mbajtur për shkak se në datën dhe në orën e njëjtë ka qenë e caktuar ceremonia e funksionalizimit të objektit të ri të gjykatës dhe gjyqtari i çështjes ka prezantuar në sallën e gjyqimit, duke konstatuar prezencën e personave të paraqitur në seancë, si dhe i ka njoftuar se për shkak të ceremonisë seanca nuk do të mbahet me ç’ rast ju ka kumtuar palëve datën dhe kohën e seancës së radhës dhe në asnjë moment nuk është paraqitur dilema e të folurit dhe gjuhës së përdoruar (marrë parasysh se padia dhe propozimi, që të dyja janë paraqitur në gjuhën shqipe). Meqenëse autorizimi i paraqitur së bashku me padi dhe propozim është paraqitur në mënyrë të përgjithësuar dhe nuk kishte informacion se i njëjti ka autorizim që të ndërmerre veprime lidhur me pronën objekt kontesti, gjykata me aktvendimin e datës 10 shtator 2024 i ka kërkuar që të dorëzohet i vërtetuar nga organi noterial në Republikën e Kosovës, siç veprohet zakonisht nga gjyqtarët në rastet kur autorizimi nuk i plotëson kushtet ligjore. Ka shtuar se kjo kërkesë gjen mbështetje me nenin 92 par. 3 të LPK-së i cili parasheh se “*Po qe se dyshohet në vërtetësinë e prokurës, gjykata mund të vendos me aktvendim që të paraqitet prokura e verifikuar. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi*”, andaj gjyqtari ka vepruar në kuptim të kësaj dispozite. Sa i përket pretendimit se gjyqtari ka shkelur nenin 96 të LPK-së, për shkak se gjyqtari nuk i ka ofruar mundësinë që të deklarohet në gjuhën e tij, ky pretendim nuk qëndron për shkak se i njëjti avokat padinë dhe propozimin e ka paraqitur në gjuhën shqipe, e po ashtu edhe në rastin e kumtimit të arsyes objektive për mos mbajtje të seancës i njëjti nuk ka paraqitur problem në të folur dhe të kuptuarit të gjuhës shqipe dhe se komunikimi me të njëjtin në gjuhën shqipe ka qenë i nivelit të lart. Andaj veprimet e gjyqtarit janë ndërmarrë duke u bazuar në nenin 96 par. 1 dhe 2 të LPK-së. Për të kuptuar pabazueshmërinë e kërkesës të paraqitur nga avokati O. C., këtë e provon edhe procesverbali i datës 10 shtator 2024 i përpiluar në gjuhën shqipe të cilin procesverbal e ka nënshkruar i njëjti pa asnjë vërejtje në drejtim të pretendimeve të paraqitura në raport me autorizimin e kërkuar dhe mosnjohjen e gjuhës në të cilin zhvillohet ky proces gjyqësor. Andaj, konsideroj se ankesa e parashtruar në drejtim të pretendimeve për shkelje të nenit 4 dhe 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është e pa bazuar dhe asnjë nga to nuk

qëndrojnë pasi që veprimet e ndërmarra në atë seancë kanë qenë në drejtim të përgatitjes për shqyrtimin e mëturjeshëm dhe se prezantimi i autorizimit nga pala e tij nuk do të ishte ndonjë problem pasi që është obligim i secilit person që të paraqes parashtrësë për dhe në emër të personit tjerë në gjykata, të ketë autorizim lidhur me ndërmarrjen e veprimeve, e që ndërmarrja e veprimeve duke u bazuar në një autorizim të gjeneralizuar është në kundërshtim me parimet e përfaqësimit të palëve para gjykatave.

Kryetari i gjykatës, pas vlerësimit dhe analizimit të ankesës së ankuesit, deklaratës së gjyqtarit, si dhe shkresave të lëndës C.nr.1535/22, gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se gjyqtari ka dal në seancë i papërgatitur pasi që gjyqtari nuk e ka kuptuar përmbajtjen e autorizimit i cili ka qenë në gjuhën serbe dhe të njëjtin autorizim nuk e ka përkthyer dhe bazuar në deklaratën e gjyqtarit, si dhe procesverbalin e seancës dëgjimore askund nuk është e konstatuar se gjyqtari ka pasur probleme me përmbajtjen e autorizimit ashtu siç pretendon ankuesi. Mirëpo në këtë procesverbal është e konstatuar se nga ana e gjyqtarit është detyruar i autorizuari i propozuesit, këtu ankuesi që gjykatës të ja prezantoj autorizimin e noterizuar nga organi noterial në Republikën e Kosovës. Aktvendimi procedural i gjyqtarit i marrë në seancë me të cilin e ka detyruar ankuesin ta prezantoj në seancën e radhës autorizimin e noterizuar, ka mbështetje në nenin 92.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe si i tillë nuk përbën shkelje disiplinore ashtu siç pretendon ankuesi.

Po ashtu është vlerësuar dhe analizuar pretendimi i ankuesit se gjyqtari ka bërë shkelje disiplinore në kuptim të dispozitave të nenin 5 par. 1.2 dhe 1.3 në lidhje me nenin 2 par. 1, 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ashtu që nuk ka vepruar sipas dispozitave të nenit 96 të LPK-së, pasi që avokatit, nuk i ka ofruar mundësinë ligjore për tu deklaruar në gjuhën e vetë edhe pse ka pas obligim ligjor sipas LPK-së dhe kryetari i Gjykatës ka konstatuar se bazuar në deklaratën e gjyqtarit, shkresave të lëndës, një pretendim i tillë i ankuesit është i pabazuar për faktin se fillimisht avokati-ankuesi të gjitha shkresat si padinë po ashtu dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit, i ka dorëzuar të përpiluara nga vetë ankuesi në gjuhën shqipe. Po ashtu edhe nga procesverbali i seancës askund nuk është e konstatuar se ankuesi ka kërkuar përkthim apo nuk ka bërë asnjë kërkesë për të i'a siguruar përkthimin. Gjithashtu kryetari i gjykatës ka konstatuar se në veprimet e gjyqtarit nuk janë bërë shkelje të nenit 96 të LPK-së, të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore pasi që me këtë dispozitë ligjore gjegjësisht me nenin 96.1 është e përcaktuar se “*Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që në procedurën para gjykatës të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë*”, ndërsa në nenin 96.2 është e përcaktuar se “*Në qoftë se procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, gjegjësisht të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojarisht në gjuhën e tyre apo në gjuhën që e kuptojnë, i të gjitha parashtrësave dhe provave shkresore, si dhe i asaj që parashtrëhet në seancë gjyqësore*”. Bazuar në deklaratën e gjyqtarit si dhe në procesverbalin e seancës, askund nuk është e konstatuar se ankuesi ka parashtruar kërkesë për përkthim gojarisht në gjuhën e tij ashtu siç është e përcaktuar me nenin 96.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si dhe bazuar në faktin se padinë dhe propozimin për caktimin e masës

së sigurimit i ka dorëzuar të përpiluara në gjuhen shqipe vetë ankuesi atëherë gjyqtari në mungesë të kërkesës dhe bazuar në faktin se të gjitha shkresat e lëndës janë dorëzuar në gjuhen shqipe nuk ka pasur për dijeni për gjuhen e ankuesit. Ashtu që në veprimet e gjyqtarit nuk janë konstatuar shkelje disiplinore të parapara me nenin 5 par. 1.2 dhe 1.3 në lidhje me nenin 2 par. 1, 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ashtu siç pretendon ankuesi.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se gjyqtari ka bërë shkelje disiplinore nga neni 5 par. 1.2 dhe 1.3 në lidhje me nenin 2 par. 1, 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pasi që edhe pse ka qenë në dijeni se seanca nuk do të mbahet dhe përfaqësuesi i palës paditëse vjen nga qyteti tjetër nuk e ka lajmëruar avokatin edhe pse një mundësi të tillë e ka pas në dispozicion, ka konstatuar se veprimet e gjyqtarit nuk përbëjnë shkelje disiplinore për faktin se shtyrja e seancës nuk ka ndodhur për shkak të gjyqtarit por për faktin se të njëjtën datë ka qenë e organizuar ceremonia e funksionalizimit të objektit të ri të Gjykatës Themelore në Gjakovë (e organizuar nga KGJK). Përkundër këtij fakti gjyqtari ka prezantuar në seancë, ka konstatuar prezencën e palëve, ka konstatuar arsyet e shtyrje se seancës dhe të gjitha palët e pranishme edhe ankuesi e kanë nënshkruar procesverbalin e përpiluar nga gjyqtari pa asnjë vërejtje.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet e gjyqtarit nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, trajtim i pabarabartë i palëve në procedurë të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtari D. B., përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
AD-GJTHGJA.nr.01/24, datë 25 shtator 2024

Kryetari i Gjykatës

Nikollë Komani

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. Parashtruesit të ankesës
3. Gjyqtarit